



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/11
Datë: 08.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe të nenit 41 dhe 50 të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 korrik 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Nga data 8 korrik 2020, duke filluar nga ora 21:00 deri në orën 05:00, ndalohet çfarëdo qarkullimi i personave fizik jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunitat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, përveç:
 - 1.1. Në raste urgjente shëndetësore;
 - 1.2. Në rast të nevojës për t'u kujdesur për të sëmurë, për persona me nevoja të veçanta, vetëm nëse të sëmurët apo personat me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten;
 - 1.3. Në rast të kërkimit të ndihmës nga institucione përkatëse, siç është rasti me viktimat e dhunës familjare;
 - 1.4. Në rast të vdekjes së anëtarit të familjes;
 - 1.5. Në rast të paraqitjes së nevojave për dalje jashtë shtëpisë/banesës për nevojat fiziologjike të kafshëve, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia (por, nuk lejohet shfrytëzimi i këtyre rasteve për të kryer ndonjë punë tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar).
2. Ndalohen hyrje-daljet 24 orë për personat e infektuar, ata të kontaktit dhe personat e dyshuar në Komunitat Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok në afat prej 14 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përveç në rasteve e përcaktuara në nënparagrafin 1.1., 1.2., 1.3., 1.4. dhe 1.5. të këtij vendimi.
3. Obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen 14 ditë kalendarike.

ARSYETIM

Ministri i Shëndetësisë ka pranuar kërkesë për ndalim qarkullimin e qytetarëve dhe ndalimin e hyrje daljeve në Komunën Mitrovicës së Veriut, Komunën e Zubin Potokut, Komunën e Leposaviqit dhe Komunën e Zveçanit. Kërkesa është bërë nga kryetarët e këtyre komunave të cilët kryesojnë shtabet lokale, pas shqyrtimit të kërkesave dhe analizimit të situatës epidemiologjike në vend në bashkëpunim me profesionistët e fushës të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, meqenëse ka rritje të numrit të qytetarëve të cilët kanë rezultuar pozitiv me COVID19 në Komunat përkatëse, me qëllim të parandalimit të përhapjes dhe kontrollit të COVID19, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë